



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 39, Datë 16/02/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.10, datë 12.01.2022, e znj. F.S.M., z. Nj.M., z. T. M., z. P.S., znj. B. M. dhe znj. E. M., ku pretendohet diskriminim, për shkak të gjendjes shoqërore, përkatësisë prindërore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë nga ana e Teatrit Kombëtar, z. H.Ç., Drejtor i Teatrit Kombëtar dhe Ministrisë së Kulturës.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Mbështetur në shpjegimet e dhëna në ankesën e depozituar nga subjektet ankues, rezulton se në datën 28.11.2021, ata janë vënë në dijeni për një shfaqje të Teatrit Kombëtar, njoftimi reklamues mbi të cilën është publikuar në faqen e rrjetit social Facebook të Teatrit Kombëtar. Kjo shfaqje ka si tematikë të saj ritrajtimin e komedisë “Prefekti”, të autorit B.L.

Për sa më sipër, të afërmit e ish-Prefektit të Tiranës, të ndjerit Q.M., pretendojnë se vepra e sipërcituar trajton në mënyrë të turpshme, thellësisht denigruese dhe jo humane figurën e tij, bashkëshortes së tij, H. M. dhe djalit të tyre, R. M. Subjektet ankuese pretendojnë se kjo vepër

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

përdor emrat dhe mbiemrat e tyre realë, duke sjellë në këtë mënyrë persekutimin e të gjithë anëtarëve të familjes M. Njëkohësisht, ata theksojnë faktin kjo shfaqje në dukje artistike, ashtu si edhe të gjithë veprat e realizimit socialist është një instrument i propagandës së regjimit totalitar komunist, ku me personazhin e Q.M. dhe bashkëshortes së tij, tallet, përqeshet dhe stigmatizohet e gjithë shtesa e deklasuar në përgjithësi dhe komuniteti autokton i Tiranës në veçanti, nëpërmjet shënjestrimit të zakoneve, traditave, dialektit dhe madje edhe të besimit fetar. Njëkohësisht, subjektet ankuese vënë në dukje faktin se janë vënë në dijeni të komenteve denigruese të Drejtorit të Teatrit Kombëtar, z. H.Ç. dhe aktorit A. D. rreth figurës së Q.M., duke arritur deri aty sa të kërkojnë llogari për akte administrative, që nuk i përkasin fare komedisë “Prefekti”. Drejtori i Teatrit Kombëtar arrin deri në atë pikë sa e quan Shoqatën “Tirona Intellectum” si spekulante vetëm për shkak të një peticioni online për të kundërshtuar veprimet e tyre.

Grupi i ankuesve sqaron se në jetën reale, vetë personazhi kryesor Q.M. është larguar nga Shqipëria dhe ka ndërruar jetë jetë në Romë, Itali, në vitin 1965, ndërkohë që menjëherë pas vënies në skenë të komedisë “Prefekti” në vitin 1949, bashkëshortja e tij, H.M.dhe djali i tij, R.M. janë internuar fillimisht në kampin famëkeq të Tepelenës dhe pastaj në kampin e Gradishtit dhe së fundi në atë të Savrës në Lushnjë. Znj. H. M. ka ndërruar jetë në kampin e internimit në Savrë të Lushnjës, ndërsa i biri ka mundur të rikthehet në qytetin e Tiranës, vetëm në vitin 1991.

Subjektet ankuese sqarojnë se kanë konstatuar që transmetimi i të ashtuquajturit lexim artistik i komedisë “Prefekti” është reklamuar nga Teatri Kombëtar, si leximi artistik i një prej komedive më të njohura shqiptare, kryevepër e B. L., në ditën e festës kombëtare të flamurit dhe me rastin e 48-vjetorit të premierës së shfaqjes me të njëjtin titull. Në ankesë theksohet fakti se leximi artistik i ka qendruar besnik thelbit të veprës origjinale, duke përdorur emrat realë të personazheve, si dhe në tërësi, duke përdorur të njëjtat shprehje, batuta dhe fraza tallëse dhe denigruese, veçanërisht ndaj figurës së Q.M. Ankuesja F.S.M. sqaron se komedia e rishfaqur në teatrin kombëtar në datën 28.11.2021 ka cënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë atë, si dhe motrat dhe vëllain e saj, sepse ata janë përndjekur gjithë jetën nga kjo komedi tallëse, e cila përdor emrat realë, duke shpifur në mënyrë të hapur në kundërshtim me faktet publikisht të njohura për jetën dhe veprat e Q.M. Në ankesë theksohet fakti se gjithmonë kur shfaqej kjo komedi, njerëzit u referoheshin atyre, në mënyrë tallëse dhe ofenduese si mbesat dhe nipi i Q.M. Subjektet ankuese sqarojnë se kjo vepër nuk është krijuar për të përndjekur Q.M., por për të denigruar të gjithë familjarët e tij.

Në ankesë sqarohet fakti se nga kërkimet e kryera në arkivin e shtetit dhe dokumentacioni i administruar përgjatë 28 viteve në asnjë rast nuk rezulton se Q.M. të ketë dhënë dënime me vdekje. Përkundrazi gjenden me qindra shkresa, ku Q.M. ndërhynte në emër të tij, duke dalë garant për të shpëtuar jetën e shtetasve shqiptarë dhe të huaj (hebrenj). Deri në vitin 1970, propaganda komuniste e akuzonte Q.M.n si të përfshirë në masakrën e datës 04.02.1944, por në

vijim historiografia e regjimit komunist e hoqi emrin e tij nga lista e personave të përfshirë në këtë masakër.

Nj.M., në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Reshit Mulleti, djali i Q.M., sqaron se ai dhe motrat e tij B. M. dhe E. M., sikurse edhe djali i hallës së tyre P.S. kanë tentuar të komunikojnë me aktorët dhe drejtorin e Teatrit Kombëtar, në profilin e këtij institucioni në rrjetin social Facebook, por janë përballur me censurë të komenteve dhe me sjellje aspak normale nga drejtori i këtij teatri, z. H.Ç., nga regjizori S. D. dhe aktorët A. D. dhe L. V. Në datën 03.12.2021, z. H.Ç. doli në media duke nxjerrë një dokument dhe duke pretenduar që trashëgimtarët e Q.M. duhet të kërkonin falje, sepse ish-Prefekti i Tiranës kishte dënuar me vdekje qytetarë shqiptarë. Subjektet ankuese deklarojnë se përmbajtja e dokumentit ishte totalisht e kundërt me atë që deklaronte drejtori i Teatrit Kombëtar, sepse ajo ishte vetëm një shkresë për të vënë në dijeni Ministrin e Brendshëm, për zbatimin e një dënimi, i cili ishte dhënë nga një gjykatë ushtarake.

Në ankesë theksohet fakti se me këto sjellje dhe veprime, Drejtori i Teatrit Kombëtar kishte si qëllim denigrimin e figurës së Q.M. dhe nuk kishte asnjë synim që të siguronte ri trajtimin e tij në aspektin real. Subjektet ankuese sqarojnë se deklaratat në media të z. H.Ç., regjizorit S. D. dhe aktorit A. D. ku informojnë se kanë patur si qëllim për të vënë në skenë një variant të ri të komedisë “Prefekti” bien poshtë vetëm, vetëm duke kryer një analizë e thjeshtë krahasuese me veprën në fjalë. Në këtë kontekst, ankuesit pretendojnë se se janë përdorur të njëjtat skena fyese e denigruese, si dhe gjuha e urrejtjes nuk ka asnjë ndryshim nga ajo e veprës, që ata e konsiderojnë si kryevepër të B. L.

Për sa më sipër, grupi i ankuesve pretendojnë diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore, përkatësisë prindërore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e subjekteve të mëposhtëme:

- 1. Teatrit Kombëtar** – me pretendimin e vënies në skenë të një vepre diskriminuese, duke përdorur emrin e familjarëve të tyre dhe duke ofenduar rëndë dinjitetin e tyre, si dhe për tentativën e rikthimit të luftës së klasave;
- 2. Z. H.Ç., Drejtor i Teatrit Kombëtar** - për komentet publike diskriminuese, që çenojnë emrin e familjarëve të tyre;
- 3. Ministrisë e Kulturës** – për mosmarrjen e masave për situatën e krijuar.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Pas analizimit paraprak të ankesës dhe akteve të depozituara në cilësi prove nga subjektet ankuese,

Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjendjes shoqërore, përkatësisë prindërore, gjendjes familjare dhe përkatësisë në një grup të veçantë duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave, Komisioneri ndjek procedurën ligjore, të parashikuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri evidenton së pari, nëse ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa.

Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore, Komisioneri reflekton mbi vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë,

disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Gjatë analizimit të kujdesshëm të përmbajtjes së ankesës dhe akteve bashkëlidhur, KMD ka konstatuar se problematika e parashtruar nga familjarët e të ndjerit Q.M., lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me komedinë e autorit B.L. me titull “Prefekti”, e shkruajtur në vitin 1948³. Kjo komedi është vënë në skenë me qindra herë dhe ka qënë në repertorin aktiv të Teatrit Kombëtar, për afro 30 vjet, nga viti 1949 deri në vitin 1975, deri në momentin, kur në vitin 1976 u regjistrua nga Televizioni Shqiptar. Komedia “Prefekti” është vënë në skenë edhe nga trupa e Teatrit “Aleksander Moisiu”, Durrës, ku roli kryesor u interpretua nga N. Xh. “Artisti i Popullit”.⁴ Baza e të gjithë realizimeve skenike ndër vite ka qënë e njëjta vepër e autorit B.L. Versionet e vëna në skenë të kësaj komedie janë transmetuar dhe ritransmetuar përgjatë viteve me dhjetra herë nga Televizioni Shqiptar. Pas viteve ‘90 e në vijim kjo komedi është transmetuar dhe vazhdon ende të jetë në transmetim nga pjesa më e madhe e mediave televizive në nivel kombëtar dhe lokal, në të gjithë Shqipërinë. Në këtë kontekst, për sa kohë që të gjitha vëniet në skenë të kësaj komedie mbështeten tek e njëjta vepër, e shkruar në vitin 1945, nga autori B.L., Komisioneri gjykon se problematika e subjekteve ankuese qendron thelbësisht tek kjo vepër.

Komedia e sipërcituar ka në qendër të saj figurën e ish-Prefektit të Tiranës, z. Q.M., i cili ka qendruar në këtë detyrë përgjatë viteve 1942-1944⁵ dhe është një ndër veprat e rralla, që është vënë në skenë, duke përdorur emrat e vërtetë të personave konkretë, duke filluar nga ish-Prefekti e duke vijuar me bashkëshorten dhe djalin e tij. Kjo vepër në vetvete ka pasur qëllim propagande në periudhën e regjimit komunist në Shqipëri, me qëllimin specifik të deformimit të historisë dhe denigrimit të figurave drejtuese në kohën e monarkisë dhe gjatë pushtimit nazifashist.

Në këtë këndvështrim, padyshim që familjarët e ish-Prefektit të Tiranës, z. Q.M., kanë një interes të ligjshëm, pasi preken direkt nga një vepër teatrale, e cila nuk shprehet në mënyrën normale të veprave me personazhe fiktivë, por përmban në brendësi të saj persona realë.

Komisioneri gjykon se çështja e parashtruar nga të afërmit dhe trashëgimtarët e të ndjerit Q.M.

³ <https://aktoretshqiptare.info/besim-B.L.-1922-1968/>; https://sq.wikipedia.org/wiki/Besim_B.L.
<https://www.facebook.com/ksh.faqjazyrtare/photos/besim-B.L.-1922-1968artist-i-merituar-heroi-i-punes-socialisteaktor-rregjizor/1371687616224436/>; <https://www.ekskluzive.al/besim-B.L.-artisti-i-kompletuar-qe-u-nda-nga-jeta-ne-kulmin-e-tij/>

⁴ <https://opinion.al/komedia-prefekti-dhe-tragjedia-e-vertete-e-hajries-dhe-reshitit/>

⁵ <https://gazetaimpakt.com/komedia-prefekti-dhe-tragjedia-e-vertete-e-hajries-dhe-reshitit/>

ka mbi të gjitha kontekst historik dhe për këtë arsye nevojiten të dhëna dhe informacion historik, për të hedhur dritë mbi figurën e vërtetë të ish-Prefektit të Tiranës. Pretendimi i grupit të ankuesve për shtrembërim dhe tjetërsim të historisë, në lidhje me figurën e Q.M., nëpërmjet komedisë së shkruajtur nga B.L., shkon pikërisht në kuadër të një diskutimi historik dhe mediatik mbi hedhjen dritë kundrejt personit bazuar në fakte historike.

Komisioneri vlerëson se arti në vetvete, i çfarëdolloj forme, është një nga manifestimet më të larta të lirisë së shprehjes. Vetë natyra e tij e bën vështirësisht të gjykueshëm dhe vlerësueshëm nën formën edhe ligjore të gjuhës së urrejtjes. Në këtë kontekst, arti gëzon mbrojtjen më të madhe të lirisë së shprehjes. Kjo nuk do të thotë që shprehja e artit është immune nga kufizimet, por që vlerësimi i këtyre kufizimeve duhet të jenë të një natyre të tillë, që t'i përgjigjen një situatë që ka cënuar rëndë dhe haptazi interesin publik të shoqërisë.

Në rastin konkret bëhet fjalë për dy të drejta që ndodhen në konflikt me njëra tjetrën. Nga njëra anë e drejta e artistëve për të projektuar një vepër teatrale, jo të krijuar rishtas, por që është shfaqur e rishfaqur shumë herë gjatë regjimit komunist, por edhe pas viteve '90 dhe nga ana tjetër e drejta e trashëgimtarëve të ish-Prefektit të Tiranës, z. Q.M., për t'u mos u shqetësuar për shkak të përkatësisë së tyre.

Përsa parashtruar, Komisioneri nuk mund të japë një vlerësim në lidhje me një vepër letrare dhe përmbajtjen e saj dhe njëkohësisht mbi vënien në skenë të kësaj veprë në formën e teatrit apo të filmit.

Vënia në skenë e një veprë letrare, e cila nuk është e kufizuar apo ndaluar nga ligji, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi Teatrin Kombëtar apo Ministrinë e Kulturës.

Nga ana tjetër, koha kur vepra letrare është shkruar, fakti i shfaqjes së saj gjatë një periudhe të gjatë kohore, vazhdimësia e transmetimit të saj, e bën të pamundur trajtimin e saj edhe për shkak të afateve kohore që ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar parashikon. Kështu, në nenin 32, pika 4, shkronjat d) e dh) të këtij ligji parashikohet shprehimisht se: "*4. Ankesa nuk pranohet nëse:d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese.*"

Në nenin 32, pika 4, shkronja b) të LMD, të ndryshuar, parashikohet gjithashtu se: "*4. Ankesa nuk pranohet nëse :... b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajteshme me dispozitat e këtij ligji*"

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankesa nr.10, datë 12.01.2022 nuk pranohet për shqyrtim, pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërmat b), d) e dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr.10, datë 12.01.2022, pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.
2. Rekomandohet që problematika e parashtruar nga ankuesit të shqyrtohet gjyqësisht pranë gjykatës kompetente.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Të mira dhe shërbime
Shkak - gjendja shoqërore, përkatësia prindërore, gjendja familjare dhe përkatësia në një grup të veçantë
Lloji i vendimit - mospranim